



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 23 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit të Hashim Thaçit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, pas konfirmimit të Aktakuzës ("Vendimi i Konfirmimit"),² Hashim Thaçi ("z. Thaçi") u arrestua në bazë të një vendimi dhe fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³
2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën e z. Thaçi për lirim të përkohshëm ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin").⁴
3. Më 24 shkurt 2021, pas një kërkesë të përbashkët të të akuzuarve në këtë çështje, të cilët gjithashtu hoqën dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin e z. Thaçi për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, deri në dhjetë

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

³ KSC-BC-2020-06, F00051, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, publik; F00027/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hashim Thaçin*, 26 tetor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën datë, F00177/RED.

ditë pas njoftimit të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelin e tij kundër Vendimit të Parë mbi Paraburgimin.⁵

4. Më 30 prill 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e z. Thaçi kundër Vendimit të Parë mbi Paraburgimin ("Vendimi i Gjykatës së Apelit").⁶

5. Më 12 maj 2021, pas një kërkesë të z. Thaçi, i cili sërish hoqi dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati sërish afatin e z. Thaçi për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, deri më 31 maj 2021.⁷

6. Më 28 maj 2021, pas një kërkesë tjetër të z. Thaçi, i cili hoqi dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati më tej afatin e z. Thaçi për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, deri më 30 qershor 2021.⁸

7. Më 30 qershor 2021, z. Thaçi dorëzoi parashtrimet e tij në lidhje me vazhdimin e paraburgimit ("Kërkesa").⁹ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj më 12 korrik 2021 ("Përgjigjja").¹⁰ Z. Thaçi u kundërpërgjigj më 19 korrik 2021 ("Kundërpërgjigjja").¹¹

⁵ KSC-BC-2020-06, F00206, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 3, 5-6.

⁶ KSC-BC-2020-06, IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën datë, IA004/F00005/RED.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00292, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Zgjatje të Afatit*, 12 maj 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00327, *Vendim mbi Kërkesën Shtesë të Thaçit për Zgjatje Afati*, 28 maj 2021, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00377, Mbrojtja e z. Thaçi, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit*, 30 qershor 2021, konfidenciale, me shtojcat A-B, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 korrik 2021, F00377/RED.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00394, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit*, 12 korrik 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën datë, F00394/RED.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00404, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë mbi Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit*, 19 korrik 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 korrik 2021, F00404/RED.

II. PARASHTRIME

8. Z. Thaçi parashtron se mbajtja e tij e mëtejshme në paraburgim është e papërligjur për shkak të ndryshimit thelbësor të rrethanave që mbështesin lirimin e tij të përkohshëm.¹² Në lidhje me këtë, z. Thaçi kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë lirimin e tij në [REDAKTUAR] të cilat kanë dhënë pëlqimin e tyre për lirimin e tij të përkohshëm në territoret e tyre përkatëse - me kushte që i gjykon të përshtatshme.¹³

9. ZPS-ja përgjigjet se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi mbetet i domosdoshëm, pasi nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që do të zhvlerësonte arsyet e përcaktuara për mbajtjen e tij në paraburgim dhe se, përkundrazi, rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë rritur që nga koha e nxjerrjes së Vendimit të Parë mbi Paraburgimin.¹⁴

10. Në kundërpërgjigjen e tij, z. Thaçi kundërshton pretendimet e ZPS-së, duke kontestuar saktësinë e tyre.¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, Dhomat e Specializuara ("DHS") mund të urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që është brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, dhe kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose kur rrethana specifike tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedimit penal; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë

¹² Kërkesa, para. 2-3.

¹³ Kërkesa, para. 2.

¹⁴ Përgjigja, para. 1.

¹⁵ Kundërpërgjigja, para. 1-20.

një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

12. Neni 41(10) i Ligjit parasheh se, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas vendimit të fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Kjo përcaktohet edhe në rregullën 57(2) të Rregullores.

13. Neni 41(12) i Ligjit parasheh se krahas masës së paraburgimit, mund të urdhërohen edhe masat në vijim, për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedimit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, paraburgimi shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

14. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi të ketë dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

15. Mbrojtja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka detyrimin të shqyrtojë domosdoshmërinë e paraburgimit çdo dy muaj, pavarësisht nëse ka “ndryshim të rrethanave”, pasi ndryshimi i rrethanave si kusht është i

domosdoshëm vetëm për rishikimin e mëtejshëm të paraburgimit me kërkesë të një të akuzuari ose ZPS-së, ose me nismën e vetë gjykatësit¹⁶.

16. ZPS-ja përgjigjet se kur shqyrton domosdoshmërinë e paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake medoemos duhet të vlerësojë se çfarë ka ndryshuar që nga vendimi i fundit mbi paraburgimin.¹⁷ ZPS-ja më tej argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë që tashmë janë vendosur në vendimin e parë mbi paraburgimin.¹⁸

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgimin, duke përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, përkatësisht nëse (i) ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale dhe (ii) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se është i pranishëm cilido nga rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.¹⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë mbi paraburgimin, por duhet të shqyrtojë arsyet ose rrethanat në fjalë dhe të përcaktojë nëse ato ende ekzistojnë. Thelbësore është që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se në kohën e marrjes së vendimit mbi rishikimin e paraburgimit, arsyet për vazhdimin e paraburgimit vijnë të ekzistojnë.²⁰ ZPS-ja ka detyrimin e vërtetimit se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.²¹

¹⁶ Kërkesa, para. 7.

¹⁷ Përgjigja, para. 3.

¹⁸ Përgjigja, para. 3.

¹⁹ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 17.

²⁰ KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 9 shkurt 2021, para. 55.

²¹ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 19, me referenca të mëtejshme: *për ngjashmëri*, ECtHR/GJEDNJ, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#) ("*Merabishvili v. Georgia* [GC]"), 28 November 2017, para. 234.

B. DYSHIMI I BAZUAR

18. Për sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer veprë penale që është brenda juridiksionit të DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.²²

19. As z. Thaçi dhe as ZPS-ja nuk kanë paraqitur parashtrime lidhur me ekzistencën e dyshimit të bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.

20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton që në Vendimin e Konfirmimit u konstatua se, në pajtim me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte, sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.²³ Këto konstatime u bënë në bazë të një standardi edhe më të lartë se standardi i dyshimit të bazuar që kërkohet në kuadër të nenit 41(6)(a) të Ligjit.²⁴ Në këtë çështje nuk ka pasur asnjë zhvillim që shfuqizon këto konstatime.

21. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vijon të ekzistojë dyshim i bazuar se z. Thaçi ka kryer vepra penale brenda juridiksionit lëndor të DHS-së, në kuptimin e nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

22. Me përmbushjen e standardit të paraparë në nenin 41(6)(a) të Ligjit, arsytet që do të përlligjnin heqjen e lirisë së një personi duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që ato duhet të specifikohen me hollësi.²⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se në bazë të provave të disponueshme, këto arsye

²² [Merabishvili v. Georgia \[GC\]](#), para. 222, me referenca të mëtejshme.

²³ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(a).

²⁴ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00007/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, publik, para. 35.

²⁵ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 20; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 23-24.

të artikuleshme dhe specifike duhet të mbështesin “besimin”²⁶ se ekziston ndonjë nga rreziqet e parapara në tre nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, që nënkupton pranimin e mundësisë, dhe jo të pashmangshmërisë, që ato të ndodhin në të ardhmen.²⁷ Me fjalë të tjera, sipas këtij standardi, duhet të tregohet se është më pak se e sigurt, por më shumë se thjesht e mundur, që ndonjë prej këtyre rreziqeve të materializohet.²⁸

23. Së fundi, kur vendos nëse një person duhet të lirohet ose të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve, të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.²⁹

1. Rreziku i arratisjes

24. Z. Thaçi parashtron se zhvillimet e fundit politike në Kosovë tregojnë qartë se ai nuk gëzon më ndikimin, popullaritetin ose mbështetjen mbi të cilat u bazua Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin kur konstatoi se ai mund të arratisë.³⁰ Në veçanti, z. Thaçi parashtron se pas dorëheqjes së tij si President i vendit në nëntor 2020, ngjarjet e përshkruara në vijim ndryshuan rrënjësisht peizazhin politik në Kosovë: (i) në zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2021, kundërshtarët politikë të z. Thaçi fituan 50.28% të votave dhe 58 vende në Kuvend;³¹ (ii) nga ana tjetër, partia politike e dikurshme e z. Thaçi (Partia Demokratike e Kosovës, “PDK”) fitoi vetëm 17% të votave të

²⁶ Shih pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

²⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 20, me referenca të mëtejshme; *shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykues I, *Vendim i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, publik, para. 17, me referenca të mëtejshme.

²⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 22.

²⁹ Në lidhje me detyrimin e shqyrtimit të “masave alternative”, *shih* KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017”)*, 26 prill 2017, publik, para. 114. *Shih gjithashtu* ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

³⁰ Kërkesa, para. 17-21.

³¹ Kërkesa, para. 18.

popullit dhe 19 vende në Kuvend, duke u shndërruar në një parti të rëndësishë marginale;³² dhe (iii) Qeveria e re, e udhëhequr nga një kundërshtar i vjetër i z. Thaçi, “spastroi” disa zyrtarë që ishin emëruar nga z. Thaçi.³³ Z. Thaçi parashtron se në këto rrethana dhe në mungesë të provave aktuale, do të ishte e paarsyeshme mbështetja e mëtejshme në “ndikimin dhe autoritetin” e tij të pretenduar mbi rrjete të gjera përkrahësish të gatshëm ta ndihmonin të arratisej, sepse kjo do të thotë t’i japësh rëndësi të tepruar një kulti personaliteti tashmë të vjetruar.³⁴ Së fundi, z. Thaçi pretendon se konstatimi se procesi në vijimësi i nxjerrjes pjesë-pjesë të materialeve përforcon motivin e tij për arratisje do të përbënte shkelje të paligjshme të prezumimit të pafajësisë së tij.³⁵

25. ZPS-ja përgjigjet se sasia e madhe e informacionit që i është nxjerrë z. Thaçi që nga marrja e Vendimit të Parë mbi Paraburgimin rrit rrezikun e arratisjes, pasi që z. Thaçi është duke u njohur gjithnjë e më shumë me tërësinë e provave kundër tij.³⁶ ZPS-ja më tej përmend pozitën me ndikim dhe autoritet të z. Thaçi mbi ish-vartësit dhe përkrahësit e tij dhe parashtron se rrjeti i mundshëm i tyre vazhdon të jetë aktiv sikurse edhe më parë.³⁷ Në lidhje me këtë, ZPS-ja përmend fushatën në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) të nisur menjëherë pas arrestimit të z. Thaçi, si dhe disa deklarata të kohëve të fundit të ushtruesit të detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së (“OVL-UÇK”).³⁸ Lidhur me argumentet e z. Thaçi mbi rezultatet e zgjedhjeve dhe zhvillimet politike të kohëve të fundit në Kosovë, ZPS-ja përgjigjet se pozita me ndikim e z. Thaçi tejkalon të gjitha zhvillimet e fundit politike, pasi bazohet kryesisht në postet e rëndësishme që ai ka mbajtur në të kaluarën. Sipas mendimit

³² Kërkesa, para. 18.

³³ Kërkesa, para. 20.

³⁴ Kërkesa, para. 21.

³⁵ Kërkesa, para. 28.

³⁶ Përgjigja, para. 5.

³⁷ Përgjigja, para. 6.

³⁸ Përgjigja, para. 6-7.

të ZPS-së, rezultatet aktuale politike nuk ndikojnë në kontaktet dhe rrjetet e krijuara gjatë kohës që ai mbante ato poste.³⁹ Së fundi, ZPS-ja hedh poshtë pretendimet e z. Thaçi për ekzistencën e një “spastrimi” sistematik dhe të motivuar politikisht të zyrtarëve të emëruar prej tij, duke përmendur një incident konkret gjatë të cilit një nga këta zyrtarë u shkarkua sepse kishte tentuar të hapte kasafortën e Presidencës.⁴⁰

26. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk ka shpjeguar pse përkrahësit e tij të pretenduar, megjithëse ende aktivë si më parë, nuk e mbështetën PDK-në në zgjedhjet e fundit parlamentare.⁴¹ Z. Thaçi kundërshton pretendimin e ZPS-së lidhur me fushatën mbështetëse të UÇK-së, duke argumentuar se kjo fushatë ishte një dështim dhe se edhe vetë OVL-UÇK-ja e kishte kritikuar si përçarëse.⁴² Z. Thaçi më tej argumenton se pretendimet e ZPS-së për funksionimin e rrjetit të supozuar të përkrahësve të z. Thaçi janë të pabazuara dhe se vendimi për zgjatjen e paraburgimit të tij në pritje të gjykit nuk mund të mbështetet në deklaratat e ushtruesit të detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së.⁴³ Për sa i takon incidentit me kasafortën e Presidencës, z. Thaçi parashtron se ZPS-ja konstatoi se në rastin në fjalë nuk ishte kryer asnjë shkelje penale, çka konfirmon natyrën politike të shkarkimit nga detyra dhe zhvlerëson pretendimet e ZPS-së mbi ekzistencën e një rrjeti të gjerë përkrahësish.⁴⁴ Së fundi, z. Thaçi rithekson se prezumimi i pafajësisë së tij do të shkelej nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nxjerrja në vijimësi e materialeve rrit rrezikun e arratisjes së tij.⁴⁵

27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fillimisht rikujton se më herët, ai konstatoi se ekziston rreziku i arratisjes së z. Thaçi, bazuar në pozitën e tij me ndikim - e cila

³⁹ Përgjigjja, para. 10.

⁴⁰ Përgjigjja, para. 11.

⁴¹ Kundërpërgjigjja, para. 4.

⁴² Kundërpërgjigjja, para. 5.

⁴³ Kundërpërgjigjja, para. 6.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja, para. 7.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja, para. 10-12.

mund t'i shtyjë përkrahësit/ish-vartësit e tij t'i mundësojnë përdorimin e burimeve dhe/ose ta ndihmojnë të arratiset - dhe bazuar në mundësinë e tij për të udhëtuar në disa vende ku nuk mund të kapet nga DHS-ja.⁴⁶

28. Sa i takon veçanërisht ndikimit dhe autoritetit të z. Thaçi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se këto buronin nga postet me ndikim që ai ka mbajtur në të kaluarën dhe rishtazi, përkatësisht: (i) anëtar themelues i UÇK-së, (ii) anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, (iii) Kryekomandant i UÇK-së, dhe së fundmi (iv) Kryeministër dhe (v) President i Kosovës.⁴⁷ Gjykata e Apelit e konfirmoi këtë konstatim dhe hodhi poshtë si jo bindës pretendimin e z. Thaçi se ndikimi i tij nuk ishte më i rëndësishëm për shkak se ai nuk kryente më asnjë funksion zyrtar.⁴⁸

29. Lidhur me zhvillimet zgjedhore dhe politike të kohëve të fundit në Kosovë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake së pari vëren se rezultatet e PDK-së në zgjedhjet e fundit parlamentare nuk janë të parëndësishme dhe nuk e shndërrojnë atë në një parti të rëndësishme marginale, siç pretendon z. Thaçi.⁴⁹ PDK-ja fitoi 17% të votave të popullit, çka e bën atë partinë më të madhe opozitare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Një rezultat i tillë tregon se përkundër dorëheqjes së z. Thaçi si President i Kosovës, PDK-ja ende gëzon mbështetjen e zgjedhësve.

30. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se rezultatet e zgjedhjeve dhe zhvillimet politike varen nga faktorë të ndryshëm dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mbështetjen ose popullaritetin afatgjatë të një të akuzuari. Duke qenë se z. Thaçi mbajti poste që i siguruan autoritet dhe ndikim në periudha që u paraprijnë zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se zgjedhjet dhe zhvillimet e fundit politike në Kosovë nuk ndikojnë në konstatimin e tij të mëparshëm se z. Thaçi vazhdon të

⁴⁶ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 31, 33.

⁴⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 31.

⁴⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 50.

⁴⁹ Kërkesa, para. 18.

ketë ndikim në Kosovë si ish-udhëheqës politik dhe ish-komandant i UÇK-së. Së pari, nuk do të thotë që përkrahësit e z. Thaçi duhet të jenë edhe votues të PDK-së. Së dyti, nisja e një fushate mbështetëse menjëherë pas arrestimit të z. Thaçi dëshmon se ai ende gëzon njëfarë ndikimi dhe autoriteti në mesin e shoqërisë kosovare, ku përfshihen edhe vartësit e mëparshëm të tij, dhe rezultati përfundimtar i asaj fushate nuk ndikon në këtë konstatim. Dhe së treti, ndikimi dhe autoriteti i z. Thaçi burojnë nga postet që ai ka mbajtur në të kaluarën si politikan dhe anëtar i lartë i UÇK-së, dhe jo nga përfshirja e tij në zhvillimet aktuale politike. Në këtë kontekst, emërimet e fundit politike të bëra nga Qeveria e re nuk janë të rëndësishme për vlerësimin nëse z. Thaçi vazhdon të gëzojë përkrahje të gjerë në Kosovë. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se zhvillimet e fundit politike nuk i pakësojnë z. Thaçi aftësinë që ai ka për shkak të posteve të tij të mëparshme dhe ndikimit që buron prej tyre, për të kërkuar mbështetjen e ish-vartësve të vet, personave të lidhur me OVL-UÇK-në dhe/ose simpatizuesve të UÇK-së, të cilët mund të jenë të gatshëm t'i mundësojnë përdorimin e burimeve dhe/ose ta ndihmojnë të arratiset, apo t'i sigurojnë qasje në informacion të rëndësishëm dhe fonde e mjete për të udhëtuar.

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake së fundi gjykon se, duke qenë në dijeni të akuzave kundër tij dhe të mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë në rast se shpallet fajtor, dhe duke u njohur me provat gjatë procesit në vijimësi të nxjerrjes së tyre, z. Thaçi tashmë ka njohuri më të plota për provat mbi të cilat mbështeten ato akuza. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ky konstatim nuk cenon në asnjë mënyrë të drejtën e z. Thaçi për t'u prezumuar i pafajshëm. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në bazë të vlerësimit paraprak të provave të paraqitura nga ZPS-ja dhe të cilat gradualisht po i nxirren z. Thaçi, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Thaçi mban përgjegjësi penale individuale, sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë, për një numër krimesh kundër njerëzimit

dhe krimesh lufte.⁵⁰ Ky konstatim është i vlefshëm dhe nuk cenon shqyrtimin e provave në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e z. Thaçi.⁵¹ Pasi ka konstatuar më parë se dijenia e z. Thaçi për akuzat kundër tij dhe për mundësinë e marrjes së një dënimi të rëndë në rast se shpallet fajtor rrit rrezikun e arratisjes së tij,⁵² Gjykatësi i Procedurës Paraprake shton se njohja më e plotë e z. Thaçi me provat mbi të cilat mbështeten ato akuza si rezultat i procesit në vijimësi të nxjerrjes së materialeve, nuk zhvlerëson këtë konstatim por përkundrazi e përforcon atë.

32. Rrjedhimisht, pavarësisht nga faktorët kompensues të saktësuar në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin,⁵³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rreziku i arratisjes në lidhje me z. Thaçi vazhdon të ekzistojë.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

33. Lidhur me rrezikun e pengimit të procesit, z. Thaçi mbështetet në parashtrimet e tij të bëra më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes dhe argumenton se zgjedhjet dhe zhvillimet e fundit politike tregojnë qartë se ai më nuk gëzon ndonjë autoritet dhe as ushtron ndonjë ndikim mbi rrjetin e pretenduar të përkrahësve që mund ta ndihmojë në pengimin e procesit para DHS-së.⁵⁴ Veç kësaj, z. Thaçi pretendon se shkalla e masave mbrojtëse të miratuara në këtë çështje,⁵⁵ jo vetëm që zvogëlon rrezikun për dëshmitarët pjesëmarrës në proces,

⁵⁰ *Shih* më lart, para. 20.

⁵¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se çdo shqyrtim i masës së paraburgimin në pritje të gjykimin bëhet në kontekstin e prezumimit të pafajësisë së personit të paraburgosur. *Shih* Aktvendimi i DHSGJK-së, 26 prill 2017, para. 113; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 17, me referenca të mëtejshme; për ngjashmëri, ECtHR/GJEDNJ, *McKay v. the United Kingdom* [GC], no. 543/03, [Judgment](#), 3 October 2006, para. 43.

⁵² Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 31.

⁵³ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁵⁴ Kërkesa, para. 17-21.

⁵⁵ Kërkesa, para. 23-24.

por zvogëlon konsiderueshëm edhe mundësinë e z. Thaçi për të penguar procesin përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe frikësimit të tyre.⁵⁶

34. ZPS-ja rithekson parashtrimet e saj të bëra më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes në kuadrin e zhvillimeve të fundit politike. Për më tepër, ZPS-ja argumenton se masat mbrojtëse nuk përbëjnë ndryshim rrethanash, pasi që në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin ishte e parashikueshme se në këtë çështje do të miratohej shkallë e gjerë masash mbrojtëse. Së fundi, ZPS-ja parashtron se masat mbrojtëse ilustrojnë qartë përmasën e rrezikut të pengimit të procesit në këtë çështje.⁵⁷

35. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se një shkallë kaq e gjerë masash mbrojtëse nuk ishte e parashikueshme, veçanërisht duke pasur parasysh praktikën e ZPS-së për të dorëzuar kërkesat e saj në mënyrë graduale.⁵⁸ Z. Thaçi më tej përsërit se shkalla e masave mbrojtëse të miratuara zvogëlon ndjeshëm mundësinë e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁵⁹

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton që në fillim se ai më herët konstatoi se ekziston rreziku që z. Thaçi të pengojë procesin para DHS-së, bazuar, ndër të tjera, në orvatjet e z. Thaçi për të minuar punën e DHS-së dhe faktin që z. Thaçi u kishte ofruar përfitime të ndryshme personave që ishin thirrur nga ZPS-ja.⁶⁰

37. Sa i përket zgjedhjeve dhe zhvillimeve të fundit politike, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e bërë më lart, përkatësisht se ndikimi dhe autoriteti i z. Thaçi mbi ish-vartësit e tij dhe personat e lidhur me OVL-UÇK-në dhe/ose simpatizuesit e UÇK-së, burojnë nga postet e tij të mëparshme. Për këtë arsye, zgjedhjet dhe zhvillimet e fundit politike nuk ndikojnë në këtë konstatim.⁶¹

⁵⁶ Kërkesa, para. 25-26.

⁵⁷ Përgjigja, para. 9

⁵⁸ Kundërpërgjigja, para. 8.

⁵⁹ Kundërpërgjigja, para. 9.

⁶⁰ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 40-41; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 52-68.

⁶¹ *Shih* më lart, para.30.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej rikujton konstatimet e Gjykatës së Apelit të bëra pikërisht në kontekstin e rrezikut të pengimit të procesit.⁶²

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej thekson se është konstatuar që z. Thaçi, mes të tjerash, ka [REDAKTUAR] dhe se ky është një prej faktorëve që mund të zmadhojnë rrezikun e pengimit të procesit.⁶³ Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh shkallën e masave mbrojtëse të miratuara deri më tani⁶⁴ dhe [REDAKTUAR].⁶⁵ Dokumentacioni i çështjes tregon se rreziku i frikësimit ose ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe/ose anëtarëve të familjeve të tyre është pashmangërisht i lartë dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është i bindur se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit mund të zvogëlohet efektivisht duke u mbështetur vetëm në masat mbrojtëse.

39. Kjo duhet të shqyrtohet së bashku me faktin se, siç u theksua më lart, si rezultat i procesit në vijimësi të nxjerrjes së materialeve, z. Thaçi tashmë ka njohuri më të plota për provat mbi të cilat mbështeten akuzat e rënda kundër tij, dhe ai vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në Kosovë për shkak të posteve të mëparshme të tij.⁶⁶

⁶² *Shih* më lart, para.28; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 50.

⁶³ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 71.

⁶⁴ KSC-BC-2020-06, F00133/COR/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Versionit të Korrigjuar të Vendimit të Parë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 14 dhjetor 2020, konfidencial; F00190/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit në lidhje me Kërkesën e Dytë të Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën e Përsëritur për Masa Mbrojtëse dhe Çështje Procedurale*, 5 shkurt 2021, konfidencial; F00211/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Tretë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 3 mars 2021, konfidencial; F00239/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Katërt në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 26 mars 2021, konfidencial; F00338/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Pestë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 4 qershor 2021, konfidencial; F00373/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Gjashtë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 25 qershor 2021, konfidencial; F00407/CONF/RED, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Shtatë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 21 korrik 2021, konfidencial.

⁶⁵ [REDAKTUAR].

⁶⁶ *Shih* më lart, para. 30-31.

40. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej rikujton se ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe pengimit të proceseve penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së,⁶⁷ siç ilustruhet nga deklarata e lartpërmendur e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së se do të publikonte edhe dokumente të tjera konfidenciale të DHS-së nëse do të merrte të tilla.⁶⁸ Edhe pse ky faktor në vetvete nuk është përcaktues për rrezikun që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit, ai paraqet kontekstin brenda të cilit duhet të shqyrtohen konstatimet e lartpërmendura konkretisht në lidhje me z. Thaçi. Ky faktor është me rëndësi duke pasur parasysh faktin se, si ish-anëtar i lartë i UÇK-së dhe figurë politike, z. Thaçi ka ndikimin që i mundëson të sigurojë mbështetjen e simpatizuesve në një atmosferë të tillë. Gjithashtu, ritheksohet se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit nuk ka nevojë të materializohet nga një i akuzuar që personalisht manipulon provat, ose ushtron ndikim ose trysni mbi dëshmitarët. Mjafton që personi i akuzuar të nxisë të tjerë, ose të ndihmojë në ndonjë mënyrë tjetër në materializimin e atij rreziku.⁶⁹

41. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit para DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

42. As z. Thaçi dhe as ZPS-ja nuk bëjnë parashtrime në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes

⁶⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 43.

⁶⁸ Përgjigjja, para. 7.

⁶⁹ KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 59.

së krimeve të tjera, në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore faktorët mbi të cilët bazohet rreziku i pengimit të ecurisë së procesit janë me rëndësi edhe për vlerësimin e rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera.⁷⁰ Më tej vlen të ritheksohet se mjafton që i akuzuari të nxisë ose ndihmojë të tjerë për të kryer krime të tilla, ose të kontribuojë në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e tyre.⁷¹

44. Duke iu kthyer fakteve në shqyrtim, krahas atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve dhe pozitës me ndikim të z. Thaçi për shkak të posteve të tij në të kaluarën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ai më herët konstatoi se mënyra e veprimit që synonte pengimin e punës së DHS-së dhe ZPS-së dhe orvatjet për të ndërhyrë në proces, tregonin se ka gjasa që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁷² Përveç kësaj, që nga Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, ai tani ka më shumë njohuri për çështjen e ZPS-së kundër tij si rezultat i procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave mbi të cilat mbështeten akuzat e rënda që i ngarkohen.⁷³

45. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, ekziston rreziku që z. Thaçi, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë, të kryejë krime të ngjashme me krimet bazë për të cilat akuzohet, kundër atyre që konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, duke përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.

⁷⁰ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 48.

⁷¹ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 24, 48.

⁷² Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 48.

⁷³ *Shih* më lart, para. 31.

4. Përfundim

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit para DHS-së, ose të kryejë krime të tjera ndaj atyre që konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, duke përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse ndonjë nga kushtet për lirim e tij mund të trajtojë në mënyrën e duhur këto rreziqe.

C. LIRIMI ME KUSHT

47. Z. Thaçi parashtron se ka marrë garanci me shkrim nga [REDAKTUAR] për lirim e tij të përkohshëm në këto [REDAKTUAR] vende,⁷⁴ dhe se këto garanci zvogëlojnë në masën e duhur rrezikun që ai të arratiset ose të pengojë ecurinë e procesit para DHS-së,⁷⁵ dhe eliminojnë çdo rrezik që ai të kryejë krime të tjera.⁷⁶ Në veçanti, z. Thaçi u referohet garancive që ka ofruar [REDAKTUAR], përkatësisht se nuk do t'i lejohet të merret me veprimtari publike ose politike, dhe do të kufizohen dhe/ose kontrollohen dhe monitorohen të gjitha kontaktet dhe komunikimet e tij, përfshirë lëvizjet fizike.⁷⁷ Z. Thaçi më tej parashtron se posti i tij i lartë nuk duhet të përdoret si argument kundër tij përderisa ai ofron garanci të shteteve të treta.⁷⁸ Duke iu referuar rregullës 56(4) të Rregullores, z. Thaçi parashtron se, pasi shtete të treta kanë dhënë pëlqimin për lirim e tij në territoret e tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të dëgjojë mendimin e shteteve të treta në të cilat ai kërkon të lirohet.⁷⁹ Së fundi, z. Thaçi rithekson zotimin e tij për

⁷⁴ Kërkesa, para. 35.

⁷⁵ Kërkesa, para. 36-38.

⁷⁶ Kërkesa, para. 35.

⁷⁷ Kërkesa, para. 37.

⁷⁸ Kërkesa, para. 36.

⁷⁹ Kërkesa, para. 33.

të përmbushur çdo kusht tjetër që mund të vendosë Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁸⁰

48. ZPS-ja përgjigjet se as Kosova e as ndonjë shtet tjetër nuk mund të bëjnë asgjë për të zvogëluar mjaftueshëm rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b).⁸¹ Konkretisht, ZPS-ja parashtron se edhe në një shtet të tretë, z. Thaçi do të vazhdonte të kishte kontakte të pakufizuara me anëtarët e familjes së tij të ngushtë dhe forcat e sigurisë të atij shteti të tretë, të cilët nga ana tjetër do të mund t'i përcillnin mesazhe dhe informacion rrjetit të përkrahësve të tij, çka do të krijonte një mundësi të rrezikshme për komunikime të fshehta.⁸² ZPS-ja parashtron se gjatë vlerësimit nëse kushtet e lirit të përkohshëm mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet, duhet të merren parasysh postet e shumta që z. Thaçi ka mbajtur në të kaluarën dhe rrjeti i përkrahësve që buron prej tyre,⁸³ dhe se pozita e lartë e tij duhet të merret parasysh edhe nëse ai nuk lirohet në shtetin e tij amë.⁸⁴ Lidhur me lirimin e përkohshëm në një shtet të tretë, ZPS-ja thekson se shtetet e treta nuk kanë të njëjtat detyrime bashkëpunimi me DHS-në si Kosova.⁸⁵ ZPS-ja parashtron se nëse bindet se asnjë kusht nuk mund të zvogëlojë rreziqet e përcaktuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të kërkojë parashtrime të tjera nga shtete të treta, në këtë rast nga [REDAKTUAR].⁸⁶ ZPS-ja parashtron se, sido që të jetë, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁸⁷ [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁸⁸ ZPS-ja parashtron se [REDAKTUAR] gjithsesi [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁸⁹

⁸⁰ Kërkesa, para. 39.

⁸¹ Përgjigja, para. 12-13, 27.

⁸² Përgjigja, para. 13.

⁸³ Përgjigja, para. 14.

⁸⁴ Përgjigja, para. 26.

⁸⁵ Përgjigja, para. 15.

⁸⁶ Përgjigja, para. 16.

⁸⁷ Përgjigja, para. 17-23.

⁸⁸ Përgjigja, para. 24.

⁸⁹ Përgjigja, para. 25.

49. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se fakti që shtetet e treta nuk kanë të njëjtat detyrime bashkëpunimi si Kosova nuk duhet të përdoret si arsye për refuzimin e kërkesës së tij për lirim të përkohshëm, pasi këto shtete garantojnë se do të bashkëpunojnë me DHS-në. Lidhur me këtë, z. Thaçi vë në dukje se njëri prej tyre është [REDAKTUAR] dhe se të dy [REDAKTUAR] janë [REDAKTUAR].⁹⁰ Z. Thaçi më tej rithekson se, në përputhje me Rregulloren, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të dëgjojë mendimin e shteteve të treta në të cilat ai kërkon të lirohet, dhe se kërkesa e tij për lirim të përkohshëm nuk mund të refuzohet mbi bazën e pretendimit se këtyre garancive të përgjithshme dhe paraprake u mungon konkretësia.⁹¹ Z. Thaçi hedh poshtë si të pabazuara pretendimet e ZPS-së mbi [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁹² Z. Thaçi më tej propozon të [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁹³ Së fundi, Z. Thaçi parashtron se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se [REDAKTUAR]⁹⁴ dhe se parashtrimet e ZPS-së mbi pamundësinë e monitorimit të komunikimeve të tij janë të pasakta.⁹⁵

50. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, sikurse konstatohet në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin, ky rrezik mund të zvogëlohet në masë të mjaftueshme mbi bazën e zotimit të z. Thaçi për të qëndruar në arrest shtëpiak, veçanërisht në një shtet të tretë që ka marrëveshje bashkëpunimi me DHS-në, dhe për t'iu përmbajtur këtyre kushteve: (i) dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit; (ii) ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar; (iii) pjesëmarrja në proces përmes videolidhjes; (iv) ndalimi i përdorimit të mediave ose i veprimtarive politike.⁹⁶

⁹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 13-14.

⁹¹ Kundërpërgjigjja, para. 15.

⁹² Kundërpërgjigjja, para. 16.

⁹³ Kundërpërgjigjja, para. 17.

⁹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 18.

⁹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 19-20.

⁹⁶ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 52, 56.

51. Sa i takon rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit para DHS-së ose kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson konstatimet e tij të mëhershme se komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen dhe monitorohen në mënyrë efektive vetëm nëpërmjet sistemit të monitorimit të komunikimeve, të zbatueshëm në objektin e paraburgimit të DHS-së, me çka zvogëlohet rreziku që ai të pengojë ecurinë e procesit para DHS-së, ose të kryejë krime të tjera apo të kontribuojë në kryerjen e tyre.⁹⁷

52. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se [REDAKTUAR]: (i) [REDAKTUAR]; (ii) [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]; (iii) [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]; (iv) [REDAKTUAR]; (v) [REDAKTUAR]; (vi) [REDAKTUAR]; dhe (vii) [REDAKTUAR].⁹⁸ [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].⁹⁹

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vlerëson të nevojshme që së pari të sqarojë fushëveprimin e rregullës 56(4) të Rregullores, të cilës z. Thaçi i referohet kur pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të dëgjojë mendimet e shteteve të treta në të cilat ai dëshiron të lirohet.¹⁰⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se leximi i përbashkët i rregullës 56(4) të Rregullores dhe nenit 41(11) të Ligjit sugjeron një përfundim të ndryshëm. Konkretisht, neni 41(11) i Ligjit përcakton që në rast të lirimit, personi që mbahet në paraburgim në objektin e paraburgimit të DHS-së në shtetin pritës, transportohet dhe lirohet, ndër të tjera, në një shtet tjetër që pajtohet ta pranojë atë. Rregulla 56(4) e Rregullores, nga ana tjetër, duke dhënë hollësi të mëtejshme për lirimin në një shtet të tretë, përcakton se i paraburgosuri nuk lirohet në shtetin e tretë pa pëlqimin e atij shteti dhe se paneli dëgjon mendimin e shtetit të tretë në të cilin i paraburgosuri kërkon të lirohet. Leximi i përbashkët i këtyre dy dispozitave, dhe në veçanti formulimi “*në rast të lirimit*” i përdorur në nenin 41(11) të Ligjit, sugjeron se paneli duhet të

⁹⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 57.

⁹⁸ Shtojca A e Kërkesës.

⁹⁹ Shtojca B e Kërkesës.

¹⁰⁰ Kërkesa, para. 33; Kundërpërgjigja, para. 15.

kërkojë mendimin e një shteti të tretë brenda kuptimit të rregullës 56(4) të Rregullores vetëm kur synon të miratojë lirin e përkohshëm, ose kur është duke e shqyrtuar një mundësi të tillë.¹⁰¹ Të argumentosh të kundërtën do të thotë të veprosh në kundërshtim me parimet e efikasitetit dhe të administrimit efikas të procesit gjyqësor, që veç të tjerash do t'i ngarkonte panelit një detyrë të tepërt dhe të panevojshme, pasi paneli do të detyrohej të kërkonte mendimin e mbase edhe disa shteteve të treta edhe në rastet kur gjykon se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm pavarësisht nga të gjitha kushtet.¹⁰² Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se rregulla 56(4) e Rregullores nuk mund të interpretohet si imponim i një detyrimi të përgjithshëm ndaj panelit që shqyrton një kërkesë për lirim të përkohshëm, ose kryen rishikim të paraburgimit *proprio motu*, që të kërkojë mendimin e shtetit në të cilin personi i paraburgosur kërkon të lirohet përkohësisht edhe kur nuk ka asnjë të ngjarë se kërkesa do të miratohet.¹⁰³ Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se një panel duhet të kërkojë informacion shtesë nga një shtet i tretë gjithmonë kur është duke e shqyrtuar mundësinë e lirit të përkohshëm me kushte të caktuara, nëse shteti i tretë ka shprehur përgjithësisht gatishmërinë dhe aftësinë për të pranuar lirin e një të paraburgosuri në territorin e vet dhe paneli nuk ka para vetes informacion të mjaftueshëm në lidhje me kushtet e lirit.¹⁰⁴ Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se edhe nëse garancitë paraprake nuk janë mjaftueshëm konkrete, kjo nuk e pengon panelin që të kërkojë informacione dhe

¹⁰¹ Për ngjashmëri, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ali Muhammad Ali Abd-Al-Rahman ("Ali Kushayb")*, ICC-02/05-01/20 OA2, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr Ali Muhammad Ali Abd-Al-Rahman against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 August 2020 entitled "Decision on the Defence Request for Interim Release"](#) ("Ali Kushayb Appeals Judgment on Interim Release"), 8 October 2020, para. 55. Pavarësisht nga ndryshimi në formulim midis rregullës 51 të Rregullores së Gjykatës së GJPN-së dhe rregullës 56(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se mund të nxirren përfundime të ngjashme.

¹⁰² Për ngjashmëri, [Ali Kushayb Appeals Judgment on Interim Release](#), para. 57.

¹⁰³ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 84, 89.

¹⁰⁴ Për ngjashmëri, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-1937-Red2 (OA9), [Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 26 September 2011 entitled "Decision on the accused's application for provisional release in light of the Appeals Chamber's judgment of 19 August 2011"](#), 15 December 2011, para. 35.

sqarime të mëtejshme nga shteti i tretë përkatës, nëse bindet se lirimi i përkohshëm i një të paraburgosuri është i mundur, me kushte të caktuara.

54. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse kushtet për lirimin e përkohshëm të z. Thaçi - qofshin ato që propozojnë shtetet e treta apo ato që mund të vendosen *proprio motu* - zvogëlojnë ose eliminojnë në masë të mjaftueshme rreziqet që përbën z. Thaçi.

55. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se asnjë kusht shtesë, përfshirë kushtet që ka propozuar [REDAKTUAR] ose kushte të tjera që mund të zbatohen në [REDAKTUAR], nuk do ishin të mjaftueshme për eliminimin rreziqeve që përbën z. Thaçi. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se edhe nëse krahas ndalimit të kontaktit me persona të tretë - me përjashtim të anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të ekipit të mbrojtjes së tij - z. Thaçi do t'i kufizohej plotësisht përdorimi i pajisjeve për telekomunikim dhe qasja në internet, kjo nuk do ta pengonte atë që t'u përcillte udhëzime personave të tjerë, si për shembull anëtarëve të familjes ose personave të tretë të cilët do të ishin detyrimisht në kontakt me të në vendqëndrimin që do t'i caktohej, me synimin për të frikësuar dëshmitarët dhe/ose për të ndërhyrë ndaj tyre. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se mesazhe të tilla mund të përcillen në disa mënyra të tjera, për shembull, duke i kërkuar dikujt të përcjellë një mesazh gojarisht ose duke përdorur një pajisje që i përket një personi të tretë. Nga ana tjetër, në objektin e paraburgimit të DHS-së, me autorizim gjyqësor, mund të vendosen masa për parandalimin e komunikimeve të tilla të paligjshme. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në këtë drejtim, pozita me ndikim e z. Thaçi dhe [REDAKTUAR] e tij [REDAKTUAR], janë me rëndësi të veçantë. Nga kjo rrjedh se komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen dhe monitorohen në mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit para DHS-së ose rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, vetëm me anë të sistemit të monitorimit të komunikimeve, të zbatueshëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.

56. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se as kushtet e propozuara dhe as ndonjë kusht tjetër shtesë nuk do të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të kërkojë mendimet e [REDAKTUAR] në lidhje me lirimin e përkohshëm të z. Thaçi në këto dy vende.

D. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

57. Z. Thaçi parashtron se lirimi i tij i përkohshëm përliqjet në bazë të rregullës 56(2) të Rregullores, duke mbajtur parasysh tejkzgatjen e paarsyeshme të paraburgimit të tij deri në fillimin e gjykimit.¹⁰⁵ Z. Thaçi argumenton se, në këtë aspekt, ZPS-ja mban përgjegjësi të plotë për një tejkzgatje të tillë të paarsyeshme, pasi ka kërkuar në mënyrë të përsëritur zgjatjen e afateve, duke shtyrë kështu datën e pritshme të fillimit të gjykimit, që ka shumë të ngjarë të fillojë në mes të vitit 2022.¹⁰⁶ Z. Thaçi më tej argumenton se hetimet e ZPS-së, të cilat ende vazhdojnë, përveç se shkelin në mënyrë të paligjshme të drejtën e tij për gjykim të drejtë, do të shkaktojnë edhe vonesa të mëtejshme.¹⁰⁷ Së fundi, z. Thaçi thekson se kufizimet aktualisht në fuqi në objektin e paraburgimit për shkak të pandemisë së COVID-19, ndërhyjnë në mënyrë joproportionale në të drejtën e tij për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.¹⁰⁸ Në veçanti, kontaktet e kufizuara të të akuzuarit me mbrojtësin e tij (kufizimet për të udhëtuar për në Holandë dhe nga Holanda, takimet me jo më shumë se dy persona në të njëjtën kohë, nga të cilët njëri duhet të jetë patjetër përkthyesi, takimet me mbrojtësit që kryhen përmes dritares pleksiglas) i pamundësojnë atij dhe ekipit të tij të përgatiten siç duhet për gjykim.¹⁰⁹

¹⁰⁵ Kërkesa, para. 8, 16.

¹⁰⁶ Kërkesa, para. 9-14.

¹⁰⁷ Kërkesa, para. 15.

¹⁰⁸ Kërkesa, para. 29.

¹⁰⁹ Kërkesa, para. 30.

58. ZPS-ja përgjigjet se Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e kishte detyrimin që të vlerësonte kohëzgjatjen e mundshme të paraburgimit në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin.¹¹⁰ ZPS-ja shton se të gjitha afatet në këtë çështje gjyqësore janë respektuar ose janë zgjatur për arsye të vlefshme, dhe se nuk ka asnjë fakt që tregon se ZPS-ja ka ngadalësuar procesin.¹¹¹ Sipas ZPS-së, z. Thaçi mbahet në paraburgim për tetë muaj bazuar në akuza që mbulojnë një gamë të gjerë krimesh luftime dhe krimesh kundër njerëzimit, të kryera gjatë një periudhe gati dyvjeçare, dhe shkalla e këtyre akuzave ndikon në të gjitha aspektet e procesit gjyqësor.¹¹² ZPS-ja gjithashtu vlerëson se kur këmbëngul se procedura paraprake është tejte e gjatë, z. Thaçi nuk mban parasysht përgjegjësinë që ka ai vetë në lidhje me këtë.¹¹³

59. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se nuk është e rëndësishme nëse janë miratuar ose jo zgjatje afatesh, pasi është e qartë se, meqë paraburgimi do t'i zgjatet për të paktën një vit nga çka vlerësohej fillimisht, zgjatjet e tilla janë bërë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.¹¹⁴ Z. Thaçi më tej hedh poshtë pretendimin se ai mban përgjegjësi në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës paraprake.¹¹⁵

60. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson që në fillim rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit.¹¹⁶ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet të merret parasysht së bashku me shkallën e rreziqeve që përshkruhen në nenin 41(6)(b) të Ligjit, për të përcaktuar nëse - duke mbajtur parasysht të gjithë faktorët - vazhdimi i

¹¹⁰ Përgjigjja, para. 28.

¹¹¹ Përgjigjja, para. 28.

¹¹² Përgjigjja, para. 29.

¹¹³ Përgjigjja, para. 30.

¹¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 1-2.

¹¹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 3.

¹¹⁶ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Paraburgimin e Tij*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.¹¹⁷ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se çështja nëse një periudhë kohe e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet teorikisht. Arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të rastit konkret, në përputhje me veçoritë e tij specifike.¹¹⁸

61. Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të paraburgimit të deritanishëm të z. Thaçi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kushton vëmendje të veçantë këtyre faktorëve: (i) se z. Thaçi u arrestua më 5 nëntor 2020; (ii) se atij i ngarkohen një numër akuzash për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte në lidhje me ngjarje që përfshijnë vendndodhje të shumta në Kosovë dhe Shqipëri gjatë një periudhe të gjatë kohore; (iii) se, nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë, përfshirë me burgim të përjetshëm; (iv) se rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me asnjë kusht; (v) se të gjithë hapat proceduralë në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë ose do të përfundojnë, me synimin e kalimit të çështjes për gjykim në një të ardhme të parashikueshme; (vi) se afatet përkatëse ose janë respektuar, ose janë zgjatur për arsye të vlefshme – në disa raste edhe me kërkesë të z. Thaçi – dhe se çdo kërkesë tjetër për zgjatje afati do të shqyrtohet në bazë të kritereve ligjore përkatëse; dhe (vii) se z. Thaçi dhe ZPS-ja vazhdojnë të mos pajtohen për datën e mundshme të fillimit të gjykimit.

62. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se koha që z. Thaçi ka kaluar në paraburgim nuk është e paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstaton se në këtë fazë të procesit, çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen e gjithsejtë të pritshme të paraburgimit të z. Thaçi para fillimit të gjykimit, është i parakohshëm dhe spekulativ. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se

¹¹⁷ *Për ngjashmëri*, Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 69.

¹¹⁸ *Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*, para. 90.

korniza ligjore e DHS-së parashikon si garanci shtesë rishikimin periodik të domosdoshmërisë së vazhimit të paraburgimit, çdo dy muaj.¹¹⁹

63. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren shqetësimet e z. Thaçi në lidhje me kufizimet e kontakteve me mbrojtësit e tij. Duke qenë i ndërgjegjshëm për vështirësitë që mund të ketë hasur z. Thaçi në vendosjen e kontaktit të plotë me ekipin e tij mbrojtës gjatë muajve të fundit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se këto kufizime duhet të shihen në kontekstin e situatës së jashtëzakonshme epidemiologjike në botë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, pavarësisht nga kufizimet e vendosura, Zyra Administrative iu përgjigj në mënyrë proaktive kësaj situatë të jashtëzakonshme, duke bërë përshtatje në punën e saj për të ruajtur shëndetin e të paraburgosurve dhe për të garantuar të drejtën e tyre për mundësi dhe mjete të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes.¹²⁰ Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) Zyra Administrative ka vënë në përdorim një Sistem për Shkëmbimin e Mbrojtur Elektronik të të Dhënave (“SSMED”) që shërben për shkëmbimin elektronik të materialeve në lidhje me çështjen dhe u ofron mbrojtësve dhe të paraburgosurve mundësi shtesë për shkëmbimin e materialeve të mbrojtjes, përmes skedarëve elektronikë të përbashkët në rrjetin elektronik të DHS-së; (ii) më 8 prill 2021 u përmirësua akustika në dhomën e këshillimit juridik në objektin e paraburgimit; dhe (iii) në fund të majit 2021, u vendosën ekrane kompjuterësh në dhomën e këshillimit juridik, në mënyrë që mbrojtësit dhe të paraburgosurit të mund të këqyrnin dokumentet njëkohësisht në kohë reale.¹²¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë gjithashtu në dukje se Zëvendësadministratori ka bërë të ditur se,

¹¹⁹ *Për ngjashmëri*, lidhur me rëndësinë e rishikimit të rregullt *shih* GJEDNJ, *Ereren v. Germany*, no. 67522/09, , [Judgment](#), 6 November 2014, para. 64.

¹²⁰ KSC-BC-2020-06, F00353/RED, Administratorja, *Version i Redaktuar Publik i “Parashtrimit të Përditësuar të Administratores në përputhje me rregullën 23(2) mbi masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19”* (“Parashtrimi i Përditësuar i Administratores në lidhje me Kovid-19”), 16 qershor 2021, publik; *shih* në veçanti, para. 6 dhe poshtëshënimi 12.

¹²¹ Parashtrimi i Përditësuar i Administratores në lidhje me Kovid-19, poshtëshënimi 12.

për shkak të përmirësimit të situatës në lidhje me pandeminë e KOVID-19, duke filluar nga korriku 2021 do të mund të kryhen sërish vizita personale në të njëjtën dhomë me mbrojtësit (tre vizitorë të privilegjuar), dhe se të paraburgosurit dhe mbrojtësit e tyre tani mund të shkëmbejnë dokumente të printuara, pa pasur nevojë t'i drejtohen oficerit të paraburgimit.¹²² Prandaj, e drejta e z. Thaçi për të komunikuar me mbrojtësin e tij, si pjesë e të drejtës për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, nuk është kufizuar në atë masë sa të dëmtojë vetë thelbin e të drejtës, dhe çdo kufizim i pretenduar i të drejtës së z. Thaçi për kontakte me mbrojtësin e tij ka pasur qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit të tij dhe të të tjerëve.¹²³

VENDIM

64. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi;
- b) **URDHËRON** z. Thaçi që, nëse dëshiron, të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, jo më vonë se **të mërkurën, 31 gusht 2021**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afatit të paraparë në rregullën 76 të Rregullores;
- c) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Thaçi vendos të mos dorëzojë parashtrime brenda afatit të përmendur më lart, të dorëzojë parashtrimet e saj në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **të hënën, 6 shtator 2021**, dhe z. Thaçi, nëse dëshiron, të dorëzojë parashtrimet e tij jo më vonë se **të enjten, 16 shtator 2021**.

¹²² KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 21 korrik 2021, publik, f. 528-530.

¹²³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se kontakti me avokatin mund të kufizohet në rast se ekzistojnë arsye të vlefshme; *shih*, ECtHR/GJEDNJ, *Campbell and Fell v. the United Kingdom*, 7819/77 and 7878/77, [Judgment](#), 28 June 1984; para. 113; *për ngjashmëri*, *Öcalan v. Turkey*, 46221/99, [Judgment](#), 12 March 2003, para.146. Dhoma e Madhe më pas konfirmoi përfundimin në çështjen *Öcalan v. Turkey* [GC], 46221/99, [Judgment](#), 12 May 2005, para.133.

nënshkrimi

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 23 korrik 2021

Në Hagë, Holandë.